



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/ 321

Datë: 09.09.2020

Procesverbal

i mbledhjes se VI (e gjashtë) të rregullt për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa
REND I DITES

1. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Malishevës për vitin 2019.
2. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 si dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021.
3. Shqyrtimi i draft Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2021.
4. Shqyrtimi i draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2021.
5. Shqyrtimi i kërkesave.
6. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 19.08.2020 duke filluar në ora 13:40, morën pjesë 6 anëtarë të KPF, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes po ju informoj se Filloreta Bytyçi mungon në këtë mbledhje, materialin e keni marrë me kohë.

Alban Krasniqi: Kanë mbete disa pika nga mbledhja e kaluar të pa trajtuara, kemi kërkuar disa raporte të plotësohen sidomos të pika e Drejtorisë për Bujqësi.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës për këtë mbledhje?

Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Malishevës për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Ky raport nuk është raport i mirëfilltë shqetësuese është sepse është raport politik, vitin e kaluar kanë qenë dy komente për menaxhimin e parasë publike, pastaj rreth aseteve kurse Auditori s'është fokusuar se në disa i kemi pas përcjellur edhe në Polici. Ky raport e qet Komunën në gjendje me të mirë e realisht është në të kundërtën pra kjo është shqetësuese. Te buxheti lëvizja në projekte ku kanë shkuar ato mjete ku kanë përfunduar, te punësimi e kanë gjetë si shkelje një rast është shqetësues pasi dikujt ju kanë mohu të drejtat që ka pas, pasi që edhe në dosje janë dokumentet veç të atij që e kanë pranuar në punë, pra në Arsim bëhet fjalë.

Halil Morina: E kemi një kërkesë të kryetarit të Komunës për stadiumin shtesë në Malishevë, të raporti i Auditimit ky raport është kredibil, por nuk me vjen mirë se kur një raport nuk del mirë s'është kredibil për ju, kur del mirë prapë nuk e pranoni. Unë mendoj se ata janë institucion por jo politik. Në përgjithësi raporti është pozitiv, rekomandimet Komuna i ka implementuar mbi 60%.

Hashim Vrenezi: Në Raportin e Auditorit këtë vite janë 13 pika që ata i kanë gjetur, por ka edhe shumë gjetje që auditori i ka mbyll sytë para një fakti real edhe ato 13 pika s'janë mirë pasi që kemi 1 milion e 400 mijë që kanë kaluar në suficit e kështu shihet edhe performanca. Ky raport tregon edhe qeverisjen, ka pas keq klasifikim të kategorive ekonomike se prapa një të keqe fshihet diçka, çështja e pronave ka mbet pa përfunduar, parregullsi në rekrutim të stafit, mangësi të kontratave për

shërbime të veçanta, mungese në projekte ekzekutive të ndërtimit, largim i operatorëve më të lirë, specifikim i çështjeve teknike të operatorëve ekonomik thjesht i kanë krye punët qysh kanë dashtë vetë, anashkalim i procedurave të prokurimit.

Alban Krasniqi: Sa i përket kredibilitetit të institucionit në fjalë pra auditorit të përgjithshëm janë do matje e jo rastësisht shteti jonë renditet në krim e korrupsion në nivel të lartë, andaj termi shtet i kapur ceket kur shihet niveli i institucioneve. E qytetarët kur vërejnë keqpërdorim obligohen të lajmërojnë keqpërdorimet e zyrtarët heshtin.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë këtë raport për Kuvendin e Komunës? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020 si dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2020/2021.

Rrahim Morina: Si raport është i vonuar, por tani e kem duhet ta trajtojmë.

Alban Krasniqi: Raporti është për pjesën tabelare, për pjesën tjetër duhet të ishte numri i nxënësve, shqetësuese është numri i rënies së nxënësve, përkundër kësaj ndërtohen shkolla, pra ndërtohen shkolla ku ka shkolla e numri i nxënësve përditë bien po këtu në pyetje është tenderi dhe shpërdorimi. Vendimmartja për ndërtim të shkollave gjithë ka qenë puro politike, si rasti i Panorcit ka qenë elektoral, pastaj në raport sa cekë testi i arritshmerisë, shujta për nxënës mirë a kanë me ditë a ka me zgjatë të ardhmen. Sa mjete janë shpenzuar për tenderin për shujta për nxënës, deri kur ka qenë tenderi dhe a ka me vazhduar më. Lidhur me ndërtimin e fushës në fshatin Shkozë a po realizohet ndërtimi, nëse jo kur do të realizohet, po ashtu për cilat anekse shkollore bëhet fjalë pasi që në fshatin Marali ende nuk ka filluar.

Te çerdhja në Malishevë në Kijevë a kanë filluar realizimi i tenderit, shkollat tani që pritet mu hapë, a janë shikuar masat alternative, cilat janë nevojat për kabinete me pas një plan konkret, qysh ka me kanë apo ndoshta procesi i kombinuar, si ka mundësi angazhimi mu ba nga arsimtaret nëpër klasë e nxënësit me përcjellë virtualisht edhe me ditë koston e zbatimit të këtyre alternativave.

Halil Morina: Më e rëndësishme të kjo pikë është se qysh ka me filluar ky vit, por modelin e përcakton MASHT dhe IKSHP. Problemi është së MASHT nuk e ka trajtuar problemin sidomos te procesi i kombinuar mësimor, mirë është me ditë se në çfarë forme ka mu mbajtur mësimi dhe si, arsimiti ka një problematike në çdo Komunë, por pse është në rënie numri i nxënësve.

Raimonda Krasniqi: Nga ajo që pash në këtë raport nuk ceket cilësia në punë, suksesi nga mësimi online. Tek kushtet disa i plotëson familja, planprogrami nuk ka korresponduar, njësitë mësimore kanë qenë konfuze për nxënësit se disa njësi ju kanë përsëritur dhe ju janë bërë pa interes nxënësve. Të dihet lista e nxënësve të cilët kanë marrë I-pad, sepse disa nxënës nuk kanë pas mundësi teknike. Sa është numri i shkollave që kanë mbajtur mësimin nga distanca 100%, cilat shkolla nuk kanë mbajtur mësimin, cilat kanë pasur vështirësi në këtë proces, çka ka ndërmarrë Komuna në këtë proces, sa është zhvilluar mësimi parafillor.

A ka grumbulluar DKAE dosjet e nxënësve për punimet në shkolla dhe çfarë ka ndodhë me nxënësit që s'kanë pas qasje në mësimin online. Uroj që mësimi mos te nis tani në këtë formë, uroj të jemi afër nxënësve.

Hashim Vrenezi: Shqetësuese është te projektet në realizim, sepse as që kanë filluar të realizohen te kemi një gjendje reale, pastaj krejt mësimdhënësit se kanë respektuar punën nga distance. Sa ka qenë qasja e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve në programin E-shkollori.

Alban Krasniqi: Këto videokonferencat ose mësimi në distancë ka qenë ka herë port e në nuk është praktikuar.

Valon Kraniqi: Nuk u përmend mirëmbajtja e shkollave gjatë kohës së pandemisë, sa janë mirëmbajtur shkollat gjatë kohës së pandemisë nga stafi teknik, shkolla janë ndërtuar bukur shumë por shumica për keqardhje e kanë mirëmbajtjen e pastërtisë.

Rrahim Morina: Gjatë kohës së pandemisë ka mësimdhënës që fare sa marrë as më lëndën që e ka dhe as me nxënës.

Kush jeni kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i draft Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2021.

Alban Krasniqi: Për këtë Draft Rregullore kryetari dhe drejtori i financave duhet me na dhanë justifikim se ku ka me shkuar Malishevë vitin e ardhshëm në mbledhjen e taksave, cilat janë standardet, a ka ndonjë ndryshim me na tregue.

Hashim Vrenezi: Kam propozuar që Komuna më ba një analizë qysh mi rritë të hyrat nga taksat, me ndërtua një statistikë për borxhet që janë ndaj komunës, me ba një politikë stimuluese për bizneset sepse 2021 mundet me kanë me mirë se tani.

Rrahim Morina: Kush jeni kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i draft Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2021.

Halil Morina: MEF ka nxjerrë ligj që krejt qeshtjet i marrin ata e Komunat e caktojnë veç pragun.

Alban Krasniqi: Pragjet a caktohen nga MEF-i, cilat janë ndryshuar dhe a ka ndonjë dallim nga ajo që janë caktuar nga Ministria, të rrugët përmendet veç rruga të jenë me harta të shenjëzuara dhe zonat me kufi ne formë hartografike.

Rrahim Morina: Kush jeni kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa e parashtruar nga AAK nr.02/281 datë: 14.08.2020

Rrahim Morina: Tash duhet një sqarim pasi që kajtaz Gashi ka kaluar në Nisma pra ka dhënë dorëheqje nga AAK, ose me kërkua sqarim nga MAPL.

Alban Krasniqi: Edhe pse skenat politike ndryshojnë standardet duhet të jenë të njëjta, një Udhëzim Administrativ e ka sqaruar mirë kur ka këso drejtësi në skenarë politike. Edhe Ligji thotë se edhe aty ku veç 1 anëtar është paraqet frymën përfaqësuese aq sa mundet me përfaqësuar.

Rrahim Morina: Sa i përket vendimit të plotësimit të KPF me dy anëtar nga Nisma, MAPL e ka kthyer vendimin thotë është në kundërshtim për mos plotësim të kuotës gjinore, por ne nuk do të merremi me atë çështje, nëse është në kundërshtim le ta dërgojnë në Gjykatë.

Halil Morina: Ky debat është bërë edhe kur janë themeluar këto komitete, por trupat e kuvendit a themelohen në bazë të rezultatit zgjedhor apo gjendjes faktike, atëherë ne si subjekt i kemi pas 13 anëtar e kemi pas funksionuar me qetë logjikë qysh tash po thoni, por edhe tash spo ju pëlqen.

Alban Krasniqi: Udhëzimi Administrativ i vitit 2018 ska lanë hapësirë.

Hashim Vrenezi: Secili mundemi me interpretuar por është një institucion mbi neve që na mbikëqyrë.

Rrahim Morina: AAK mundet me kërkua në MAPL sqarime për këtë çështje.

Valon Krasniqi: Ka keqkuptim se LDK si ka thy parimet në bashkëpunim.

Rrahim Morina: Unë po e hedh në votim këtë kërkesë, kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend?

Për 1, kundër 3, abstenime 2.

Kërkesa nr.02/283 datë 18.08.2020 e parashtruar nga Drejtori i shkollës fillore të fshatit Lumishtë Sokol Paçarizi.

Rrahim Morina: Lidhur me këtë kërkesë sipas Ligjit, Komuna-kryetari duhet me ba kërkesën.

Alban Krasniqi: Ky mentalitet kështu me qu sallë në katundin e vet kujt ti teket nuk shkon kështu, kërkesat shkojnë prej planeve të Komunës, kjo në këtë formë është puro politike. Qohet një injorant i thotë shkollës shko bëni kërkesë.

Rrahim Morina: Unë parashtruesit të kësaj kërkesë ja sqaroj edhe vetë sa janë disa procedura që duhet të ndjekën.

6. Të ndryshme

Valon Krasniqi: Komitetet që janë të formuara prej Kuvendit spi marrin mjetet, tani edhe produktiviteti spo ashtë në punë.

Rrahim Morina: Listat i kemi përgatitë për secilin Komitet për pagesa, por në Ministri i kanë bllokuar.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:50

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

